



VENDIM

Nr. 13, Datë 16.02.2016

**MBI
TARIFËN FIKSE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U PAGUHET
PRODHUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA
HIDROCENTRALET PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të neneve 16 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 15 pika 3, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, të ndryshuar, VKM nr. 1033 date 16.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet” si dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE Nr. 156, Datë 24.12.2015, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, pasi shqyrtoi, relacionin e Drejtorive Teknike mbi tarifën fikse e energjisë elektrike, që do t’i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, si dhe informacionin shtese të kërkuar,

Konstatoi se:

- VKM nr. 1033, datë 16.12.2015, ka miratuar Metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga Hidrocentralet” në të cilën është përcaktuar se “Çmimi i shitjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X koeficientin 1.24 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.
- Raportit vjetor (Physical futures Annual report) nga bursa e Hungarisë HUPX për vitin përkatës është botuar.

- Bordi i ERE-s në pikën 3 të vendimit nr. 156 date 24.12.2015 ka përcaktuar se, pas publikimit të Raportit vjetor (Physical Futures Annual Report) nga bursa e Hungarisë HUPX për vitin përkatës, siç përcaktuar në VKM Nr. 1033, datë 16.12.2015, ERE do të shprehet me vendim “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2016, prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.
- Bordi i ERE-s në pikën 2 të vendimit nr. 156 date 24.12.2015, ka përcaktuar se: Fuqia juridike e Vendimit Nr. 27 të Bordit të Komisionerëve të ERE, datë 16.02.2015 “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t’i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, zgjatet deri në marrjen e vendimit të shfuqizimit të tij nga Bordi i ERE

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

- 1- Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t’i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, do të jetë 7.448 leke/kWh.
- 2- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 27 date 16.02.2015 i Bordit të Komisionerëve të ERE, “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t’i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet.
- 3- Diferencat që mund të rezultojnë, ndërmjet çmimit të miratuar për vitin 2016 dhe çmimit të miratuar për periudhën e ndërmjetme me vendimin e Bordit të ERE Nr 156 Datë 24.12.2015, do të sistemohen nëpërmjet korigjimit të faturimeve përkatëse.
- 4- Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2016.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare

